



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:229649

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05313167

C.nr.43/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditëses B.E me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim E.S pranë D.. sh.p.k, me sei në Prishtinë, kundër të paditurve F.V dhe N.V nga Vushtrria tani me adresë të pa njohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.E.S nga Vushtrria, si dhe të paditurit S.T nga Mitrovica, lidhur me kthim të borxhit të kredisë, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, jashtë seance, me datën 12.02.2024 e mori dhe e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I. OBLIGOHEN të paditurit F.V dhe N.V nga Vushtrria tani me adresë të pa njohur si dhe i padituri S.T nga Mitrovica që solidarisht në emër të kthimit të kredisë, paditëses B.E me seli në Prishtinë, të 'ia paguajnë solidarisht shumën prej 9176.03 euro.

II. OBLIGOHEN të paditurit që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajnë paditëses SOLIDARISHT shumën totale prej 1081,64 euro dhe atë në emër të taksës për padi shumën prej 60 euro dhe në emër të shpenzimeve të shkaktuara nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve F.V dhe N.V, av.E.S nga Vushtrria, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësja B.E me seli në Prishtinë, me padinë e ushtruar dhe të precizuar në seancën e dt. 01.12.2023 ka kërkuar nga gjykata që në emër të kthimit të kredisë, ti obligoj të paditurit që të paguajnë solidarisht shumën prej 9176.03 euro, (5904.49 euro në emër të kryegjësë, 1529,19 euro në emër të interesit të kontraktuar apo kamatës së rregullt, 1742,35 euro në emër të kamatë voneses si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës aq sa do të krijohen.

Gjykata, me datën 31.01.2024, ka caktuar seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesi i paditësit E.S, përfaqësuesi i të paditurve F.V dhe N.V, av.E.S nga Vushtrria si dhe i padituri S.T.

Përfaqësuesi i paditëses E.S gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pranë padis dhe kërkesëpadisë së precizuar dhe i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj si të bazuar duke i detyruar të paditurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve F.V dhe N.V, av.E.S nga Vushtrria gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me pretendimin ndër të tjera se kërkesa e paditëses është e parashkruar.

I padituri i tretë S.T gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata, pas administrimit të provave, të njëjtat i lexoi një nga një, bazuar në nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe atë: marrëveshjen mbi pengun e lidhur mes paditëses dhe të paditurve e datës 20.06.2011, nga e cila vërtetohet se paditësja ka lidhë marrëveshje mbi pengun me të paditurit dhe të paditurit kanë lënë kolateral në vlerë prej 21,200 për kredinë e marrë prej 7,000 euro, marrëveshjen kreditore për kredi për individ e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse të datës 20.06.2011, nga e cila vërtetohet se banka është pajtuar tu akordojë huamarrësve në lartësi prej 7,000 euro, për një periudhë kthimi prej 36 muajve, aneksin – 1 i koletaralit në emër të të paditurit F.V, nga i cili vërtetohet se i padituri F. është pajtuar të lë peng tri gjësende të luajtshme dhe atë automjetin Citroen Berlingo, friz për kpurdha dhe tharëse kpurdhash në vlerë prej 14,800 euro, aneksin – 1 i koletaralit në emër të të paditurit S.T, nga i cili vërtetohet se i padituri S.T është pajtuar të lë peng një gjësend të luajshëm dhe atë automjetin Golf IV, në vlerë prej 6,400 euro, propozimin për sekuestrimin e objektit të pengut (koletaralit), i paraqitur pranë kësaj gjykate me datën 29.10.2012 nga i cili vërtetohet se paditësja ka paraqitë propozim për ekzekutim ndaj të paditurve F. dhe N.V, me qëllim të sekuestrimit të objektit të pengut (koletaralit), i specifikuar në marrëveshjen mbi pengun e lartcekur, kërkesën për transferimin e lëndës tek përmbaruesi privat nga kjo gjykatë e datës 06.06.2014 me të cilën paditësja ka kërkuar transferimin e lëndës së lartcekur përmbarimore për tek përmbaruesi A... në Vushtrri, konkluzionin e kësaj gjykate të datës 09.06.2014 me të cilin lënda në fjalë përmbarimore është transferuar tek përmbaruesi privat, urdhërin përmbarimor të përmbaruesit privat A... P.nr.46/14 të datës 16.08.2023 nga i cili vërtetohet se ka përfunduar procedura përmbarimore në bazë të parashtrësës së paditëses e paraqitur pranë përmbaruesit në fjalë me datën 22.08.2017, me të cilën parashtrësë e ka terheqë propozimin për përmbarim për shkak të pa mundësisë së përmbarimit respektivisht tjetërsimit të koletaralit të lënë peng tek paditësja atëherë kreditori, historiatin e llogarisë bankare të lëshuar nga paditësja në emër të të paditurit F.V për periudhën kohore nga data 01.01.2011-08.08.2023, nga e cila vërtetohet se i padituri F.V, nga i cili vërtetohet se i padituri F.V për herë te fundit ka paguar një shumë të kredisë në lartësi prej 198.50 euro në vitin 2016.

Nga provat e administruara si më lart, nuk është kontestues fakti se paditësja i ka lëshuar kredi të paditurit të parë, në shumë prej 7,000 euro, ndërsa nuk është kontestues fakti që për kredinë në fjalë, i padituri i dytë dhe i tretë kanë garantuar me marrëveshje garantuese për këtë kredi.

Gjykata, nga provat në fjalë, gjen se i padituri nuk e ka paguar pjesërisht kredinë në fjalë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa paditëses i kanë mbetur në obligim shumën 5904.49 euro në emër të kryegjësë, 1529,19 euro në emër të interesit të kontraktuar apo kamatës së rregullt dhe 1742,35 euro në emër të kamatës voneses, respektivisht sipas rrjedhjes së kamatës borxhi i përgjithshëm ka arritur në vlerë të tërësishme prej prej 9176.03 euro.

Gjykata, me rastin e vendosjes mori parasysh edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurit av.E.S se kërkesa e paditëses është parashkruar mirëpo ky pretendim është i pa bazuar pasi që paditësja me datën 29.10.2012 ka paraqitë propozimin për sekuestrimin e objektit të pengut (koletaralit), kundër të paditurve, pranë kësaj gjykate, e me të cilin veprim (paraqitje të propozimit për përmbarim) e ka ndërprerë afatin e parashkrimit sic edhe parashihet me nenin 389 të LMD-së së vjetër ku përcaktohet se: Ndërprerja e parashkrimit e bërë me ngritjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimin të kërkesës,

konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditor heq dorë nga padia ose veprimi që ka ndërmarrë.

Veprimi i ndërmarrë nga paditësja pra inicimi i procedurës përmbartimore ndaj tani të paditurve, ka zgjatur gjerësa kreditori tani paditësja për shkak të tjetërsimit të koletaralit nga ana e debitorëve tani të paditurve, gjerë me datën 22.08.2017 kur edhe paditësja e ka tërheqë propozimin për përmbartim për shkak të pa mundësisë së përmbartimit respektivisht tjetërsimit të koletaralit të lënë peng tek paditësja atëherë kreditori.

Gjithashtu nga historiat i llogarisë bankare të lëshuar nga paditësja në emër të të paditurit F.V për periudhën kohore nga data 01.01.2011-08.08.2023, vërtetohet se i padituri F.V, për herë te fundit ka paguar një shumë të kredisë në lartësi prej 198.50 euro në vitin 2016, ndërsa paditësja në vitin 2018 e ka paraqitë padinë për kthimin e borxhit me cka gjykata vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses nuk është e parashkruar pasi paditësja propozimin për përmbartim atëherë si kreditor nuk ka heq dorë nga propozimi për përmbartim ose veprimi që ka ndërmarrë por vetëm e ka tërheqë për të paraqitë menjëherë pas një viti padinë për kthim borxhi, me të cilin e ka ndërprerë afatin e parashkrimit të ndërprerë më herët me propozimin për përmbartim.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por se të njëjtat ishin irelevante për vendosje tjetër në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës I të dispozitivit u bazua në nenin 17, par.1, nenin 262, neni 124, nenin 394 dhe nenin 1005 të Ligjit mbi Marredheniet e Detyrimeve (vitit 1978), ngase konstatoj se ekziston parimisht detyrimi i të paditurit të parë për kthimin e borxhit nga kredia e marrë prej paditëses e gjithashtu edhe detyrimi i të paditurve tjerë në cilësinë e garantuesve-dorëzanëve për pagesën e këtij borxhi, nëse i padituri i parë për çfarëdo arsye nuk paguan detyrimin ndaj paditëses.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës II të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, u bazua në nenin 452 të LPK-se, ashtu që vendosi që shpenzimet e procedurës kontestimore ti bartin të paditurit solidarisht sikurse, shpenzimet procedurale.

Gjykata, aktgjykimin e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**  
**Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil**  
**C.nr.43/18 datë: 12.02.2024**

**GJYQTARI**  
**Izet Gërguri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.